

V E N D I M
Nr.147, datë 5.4.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.82, DATË
2.3.1994 “PËR ÇAKTIMIN E VLERAVE MINIMALE PËR ÇMIMET E MALLRAVE,
TARIFAT E TRANSPORTIT DHE ATO TË SIGURIMIT, QË DO TË ZBATOHEN NGA
ORGANET DOGANORE PËR LLOGARITJEN E VLERËS DOGANORE”**

Në mbështetje të nenit 1 të dekretit nr.750, datë 11.1.1994 “Për një ndryshim në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.82, datë 2.3.1994, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.94, datë 11.3.1994, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 7 të listës 2 shtohet shkronja “g” si më poshtë:

g) Çimento

- rinfuzo	tonë	25
- në thasë	“	35

2. Pika 12 e listës 2 ndryshohet si më poshtë:

12. Këpucë e çizme (qoftë edhe sportive)

a) Prej lëkure

- me numër deri 34	palë	3
- me numër mbi 34	“	10

b) Prej materialesh të tjera (imitacione të lëkurës, tekstili, plastike etj.)

- me numër deri 34	palë	1
- me numër mbi 34	“	4

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 10 mars 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi